



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 2143/8 Prot.

Tiranë, më 11.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 40, datë 11.12.2024**

**PËR KONTROLLUESIN SHKOLLA JOPUBLIKE “ALBANËT I-M”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shkolla Jopublike “Albanët I-M” (në vijim “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 167, datë 01.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Verifikim i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit Nr. 37, datë 25.10.2023 (në vijim “Rekomandimi”) të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për Kontrolluesin Shkollës “Albanët I-M”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS K31802019N, dhe ushtron aktivitetin si institucion arsimor privat parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor

*parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar. Gjatë inspektimit u konstatua se dokumentacioni nxënës, punonjës, kujdestar ligjor mbaheshin pa afat.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë, “*nxënës*”, “*punonjës*”, “*kujdestar ligjor*”, “*kandidat për punë*”, “*vizitorë të faqes së internetit www.albanet.edu.al*”, si dhe “*vizitorë të ambienteve të zyrave*”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 1 të Rekomandimit për përcaktimin e kohës së ruajtjes së të dhënave personale që përpunon gjatë ushtrimit të aktivitetit në përputhje me ligjin.

Nga verifikimi i dokumentacioni të administruar nga grupi i kontrollit si dhe nga shqyrtimi i rregullores të vendosur në dispozicion për “*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Shkollën Albanët I-M*” të miratuar me nr. 837/1 prot., datë 04.09.2023, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka parashikuar një afat konkret për ruajtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me germen “d” të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit si dhe udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “*Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat*”, i ndryshuar (në vijim “*Udhëzimi nr. 11*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar, në përputhje me parashikimin e gremës “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

3. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 3 të Rekomandimit për informimin e subjekteve të të dhënave për formularin “*Deklaratë e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale*” në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Kontrolluesi aplikon formularin “*Deklaratë e pëlqimit për përpunimin e të dhënave personale*” për prindërit/kujdestarin ligjor, nëse është dakord ose jo për publikimin e fotografive të fëmijëve në rrjetet sociale të tilla si “*Facebook*” dhe “*Instagram*”. Megjithatë konstatohet se, informimi nga Kontrolluesi nuk është shterues në lidhje, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave, të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në

praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit, mund të sjellë pasoja, sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Kur mbledh të dhëna personale, Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, mënyrën e përpunimit, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij, etj.

4. Kontrolluesi nuk ka përbushur pikën 4 të Rekomandimit lidhur me marrjen e masave për përfshirjen në Rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, të masave konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kontrolluesi disponon “*Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”. Megjithatë, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, Rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura teknike-organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, (për çdo kategori subjektsh), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

5. Kontrolluesi nuk ka përbushur pikën 5 të Rekomandimit lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.

Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, si dhe Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim “*Udhëzimi nr. 47*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, natyrës së veprimtarisë që ushtron, si dhe për shkak të kategorive të të dhënave personale që përpunon, kërkohen masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale. Sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit

të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 21.11.2024, paraqiti pretendimet mbi konstatimet e procesverbalit dhe vendosi në dispozicionin dokumentacionin për rikuperimin e shkeljeve dhe masat e marra si vijon:

- Formular njoftimi;
  - Formularë deklarimi datë: 17/10/2023;
  - Formularë deklarimi datë 30/10/2024;
  - Rregullore për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale në shkollën “Albanët I-M”, nr. 837/2 prot., datë 12.11.2023;
  - Deklarata e pëlqimit për përpunim të dhënash personale;
  - Deklaratë pëlqimi;
  - Deklarata e pëlqimit për përpunim të dhënash personale për stafin e shkollës “Albanët I-M”;
  - Deklaratë konfidencialiteti;
  - Print screen Politikat e Privatësisë nga Faqja Zyrtare e Shkollës 9 – vjeçare “Albanët” <https://albanet.edu.al/>;
  - Modul trajnimi për “Mbrojtjen e të dhënave personale”, Listëprezencë e personelit të trajnuar, vërtetim lëshuar nga trajnuesi mbi pjesëmarrjen në trajnim të stafit;
  - Kontratë për shërbime IT dhe sigurinë e informacionit, bashkangjitur deklaratë konfidencialiteti nënshkruar nga ofruesi i shërbimit AlbaTech System shpk;
  - Kontratë shërbimi me Shoqërinë e Sigurisë Private Ro.Gat Security shpk;
- Lidhur me formularët e “*Deklaratave të Pëlqimit për Përpunimin e të Dhënave Personale*”, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në këto deklarata informimi nuk është i plotë. Informimi nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

- Lidhur me rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Zyra e Komisionerit vlerëson se, nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, Rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave “a”; “b” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mospërmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 27, 30, 39 (pika 1, germat “a”, “b” dhe “dh”), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **VENDOSA:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;

4. Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, në përputhje me germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për përfshirjen në rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
7. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - i. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 më sipër;
  - ii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

8. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
9. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
10. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 11.12.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**